



# INFORMACION PRAKTIK mbi Proceset Zgjedhore në Shqipëri

UN Women mbështet pjesëmarrjen e barabartë dhe gjithëpërfshirëse të grave në proceset zgjedhore, si kandidatë ashtu edhe si votuese. Ky dokument synon të lehtësojë aksesin në informacion mbi procesin zgjedhor në Shqipëri për gratë kandidatë që planifikojnë të garojnë si anëtare të partive politike ose si kandidatë të pavarura, përfshirë ato nga komunitetet e nënpërfaqësuar. Zbatimi i legjislacionit zgjedhor bazuar në parimet e barazisë gjinore në Shqipëri është kyç për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), veçanërisht Objektivin nr. 5, si dhe për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).

Ky dokument është i dobishëm jo vetëm për gratë, por për të gjithë kandidatët/et potencialë dhe përfshin informacion praktik mbi zgjedhjet në Shqipëri, si për zgjedhjet qendrore ashtu edhe për ato vendore, si dhe mjete për adresimin e pabarazive gjinore në proceset politike.

Në këtë publikim do gjeni informacion të përmbledhur të sistemit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore në Shqipëri, si dhe mbi aspektet praktike, përfshirë kërkesat ligjore për kandidatët/ët, financimin e zgjedhjeve dhe procesin e monitorimit financiar të shpenzimeve zgjedhore për partitë politike dhe kandidatët/ët. Gjithashtu, këtu do të gjeni informacion mbi legjislacionin shqiptar për barazinë gjinore në zgjedhje, duke përfshirë të dhëna për pjesëmarrjen e grave në zgjedhjet e mëparshme.



## Përmbajtja

<b>Sistemi Zgjedhor në Shqipëri për zgjedhjet e përgjithshme .....</b>	<b>3</b>
<b>Sistemi Zgjedhor në Shqipëri për zgjedhjet vendore .....</b>	<b>4</b>
<b>Regjistrimi i kandidatëve/ëve.....</b>	<b>5</b>
<b>Kandidatët/ët e pavarur .....</b>	<b>6</b>
<b>E drejta për kandidim .....</b>	<b>7</b>
<b>Financimi i zgjedhjeve.....</b>	<b>8</b>
<b>Ndalimet në lidhje me financimin e zgjedhjeve .....</b>	<b>10</b>
<b>Shpenzimet, raportimi dhe monitorimi i veprimtarive financiare të subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve/ëve.....</b>	<b>11</b>
<b>Periudha zgjedhore dhe fushata .....</b>	<b>12</b>
<b>Barazia gjinore dhe zgjedhjet në Shqipëri .....</b>	<b>13</b>
<b>Zgjedhjet e përgjithshme .....</b>	<b>13</b>
<b>Zgjedhjet vendore .....</b>	<b>15</b>
<b>Sfidat në lidhje me barazinë gjinore .....</b>	<b>15</b>
<b>Zhvillimet e fundit ndërkombëtare për barazinë gjinore në zgjedhje.....</b>	<b>17</b>

## Sistemi Zgjedhor në Shqipëri për zgjedhjet e përgjithshme

Që nga organizimi i zgjedhjeve demokratike në vitin 1991, Shqipëria ka zbatuar disa sisteme zgjedhore, duke përfshirë maxhoritarin, proporcionalin dhe një përzjerje të të dyjave. Sistemi aktual në fuqi që nga viti 2008 është një sistem proporcional rajonal i bazuar në zona zgjedhore me listë shumëëmërore.

- një sistem rajonal proporcional: Kuvendi prej 140 deputete/ësh zgjidhet për një mandat katërvjeçar. Kandidatet/ët zgjidhen nga 12 njësi zgjedhore që korrespondojnë me qarqet administrative.<sup>1</sup> Partitë politike, koalicionet e partive dhe grupet e zgjedhëseve/sve (subjektet zgjedhore) kanë të drejtë të propozojnë kandidatet/ët.<sup>2</sup> Për t'u kualifikuar për shpërndarjen e vendeve në parlament, faktorët politikë duhet të kapërcejnë një prag prej një për qind në mbarë vendin.
- Në bazë të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor në korrik 2024, sistemi në Shqipëri konsiston në: dy forma që rregullojnë strukturën e fletës së votimit: **a) lista shumëëmërore me renditje të fiksuar të kandidateve/ëve; dhe b) lista shumëëmërore e kandidateve/ëve, që i nënshtrohen votimit parapëlqyes.**
  - Në rastin e parë, emrat e kandidateve/ëve të subjektit zgjedhor paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një.<sup>3</sup> Numri i përgjithshëm i kandidateve/ëve në listën me renditje të fiksuar është i barabartë me numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore pjestuar për tre (që do të thotë 1/3 e kandidateve/ëve).<sup>4</sup>

<sup>1</sup> Më 11 dhjetor 2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) rishpërndau numrin e mandateve për çdo qark, duke filluar nga 3 në Kukës në 36 në Tiranë.

<sup>2</sup> Një kandidat mund të ketë emrin vetëm në një listë. Listat e kandidateve/ëve duhet të mbështeten nga 5 000 nënshkrime votuesish për partitë ose 7 000 nënshkrime për koalicionet në mbarë vendin. Votuesit mund të mbështesin lista të shumta.

<sup>3</sup> Për koalicionet përbri emrit të kandidates/it shënohet cilës parti i përket kandidatja/i.

<sup>4</sup> Emrat në listën shumëëmërore me renditje të fiksuar të kandidateve/ëve të subjektit zgjedhor paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Për koalicionet përbri emrit të kandidates/it shënohet cilës parti i përket kandidatja/i. Numri i përgjithshëm i kandidateve/ëve në listën me renditje të fiksuar është i barabartë me numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore pjestuar për tre. Në rast se nga ky pjestim nuk rezultojnë numër i plotë mandatesh atëherë në rast se presja dhjetore si pasojë e pjestimit është e barabartë ose më e madhe se 0,5 lista përmbillet me numrin e plotë pasrendës, ndërsa kur si pasojë e pjestimit rezultojnë presja dhjetore më e vogël se 0,5 lista shumëëmërore me renditje të fiksuar e kandidateve/ëve mbyllet me numrin e plotë pararendës.



- Në rastin e dytë, lista shumëemërore e kandidateve/ëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes nga zgjedhëset/it është e barabartë me numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore. Rënditja e kandidateve/ëve bëhet sipas rendit alfabetik të mbiemrit për secilën/in prej tyre. Kandidatja/i për deputet, e/i regjistruar në listën shumëemërore me renditje të fiksuar të partisë politike apo koalicionit nuk mund të jetë njëkohësisht edhe në listën shumëemërore të kandidateve/ëve për deputete/ë që i nënshtrohen votimit parapëlqyes.

Amendamentet e vitit 2024 ndryshuan sistemin e mëparshëm, i cili konsistonte vetëm në votimin preferencial, ku votueset/it mund të zgjidhnin midis partisë ose koalicionit të tyre të preferuar, si dhe të votonin për kandidaten/in e tyre të preferuar nga lista e zgjedhur, gjë që i lejoi votueset/it të ndikonin potencialisht në renditjen e të gjithë kandidateve/ëve në listë.

Pas procesit të votimit, përdoret një formulë për përlogaritjen dhe shpërndarjen e mandateve për kandidatet/ët fitues/e, bazuar në votat e marra në çdo qark.<sup>5</sup> Mandatet për kandidatet/ët fitues fillimisht shpërndahen sipas renditjes së listës shumëemërore me renditje të fiksuar të subjektit zgjedhor dhe në përputhje me renditjen e kandidateve/ëve në të. Në rast shterimi të saj, shpërndarja vijon me kandidatet/ët fitues të rirenditur të listës shumëemërore që i nënshtrohen votimit parapëlqyes, në bazë të numrit më të lartë të votave të marra nga secili/a kandidat/e.

Nga ana tjetër, amendamentet e vitit 2024 sigurojnë votën e shtetaseve/ve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, gjë që konsiderohet një arritje e madhe për sistemin demokratik në Shqipëri.

## Sistemi Zgjedhor në Shqipëri për zgjedhjet vendore

Kryetaret/ët e bashkive dhe anëtarët/ët e këshillave vendore për 61 bashkitë zgjidhen drejtpërdrejt për një mandat katërvjeçar. Kryetaret/ët e bashkive zgjidhen me shumicë votash me një raund dhe anëtarët/ët e këshillave vendore zgjidhen nga lista të mbyllura sipas sistemit proporcional. Njësitë zgjedhore për zgjedhjet vendore janë territoret e bashkive. Numri i këshilltareve/ëve në çdo bashki përcaktohet sipas numrit të popullsisë dhe varion nga 15 deri në 61. Të gjitha partitë dhe koalicionet duhet të paraqesin lista me numrin e kandidateve/ëve të barabartë me numrin e vendeve në këshillin bashkiak përkatës, plus një. Një kandidat/e mund të paraqitet vetëm në një listë

<sup>5</sup> Për më shumë, ju lutemi shihni nenet 162 dhe 163 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar në vitin 2024.

dhe renditja në listat e kandidateve/ëve nuk mund të ndryshohet pas regjistrimit. Këshilltaret/ët e zgjedhur marrin mandate sipas renditjes në listën e kandidateve/ëve. Nuk ka asnjë prag si kriter për t'u kualifikuar për ndarjen e vendeve në këshillat vendorë.<sup>6</sup>

### Legjislacioni kryesor për zgjedhjet

Kushtetuta ([Eng.](#) [Alb.](#)) Amendimet më të fundit lidhen me zgjedhjet në 2020

Kodi Zgjedhor<sup>7</sup> ([Eng.](#) [Alb.](#))

Ligji për Partitë Politike ([Alb.](#))

Ligji për Dekriminalizimin ([Alb.](#))

Udhëzimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për Procesin e Regjistrimit të Subjekteve Zgjedhore ([Alb.](#))

### Regjistrimi i kandidateve/ëve<sup>8</sup>

Subjektet zgjedhore që kanë të drejtë të regjistrohen në zgjedhjet e përgjithshme dhe ato vendorë janë:

- **Partitë politike:** Partitë politike paraqesin kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ jo më vonë se 75 ditë përpara datës së zgjedhjeve.
- **Koalicioni i partive politike:** Koalicioni i partive politike përbëhet nga dy ose më shumë parti politike që paraqesin kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve.
- **Kandidati i pavarur** i propozuar për deputet nga zgjedhëset/it.

Për zgjedhjet e përgjithshme, partitë politike ose koalicionet zgjedhore të regjistruara duhet të depozitojnë në KQZ listën e kandidateve/ëve për secilën prej 12 zonave zgjedhore dhe dokumentacionin përkatës jo më vonë se

<sup>6</sup> OSBE (2023), Zgjedhjet vendorë, 24 maj 2023, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i ODIHR-it, Raporti Përfundimtar

<sup>7</sup> Versioni i përditësuar i Kodit Zgjedhor me ndryshimet e vitit 2024 gjendet vetëm në versionin në gjuhën shqipe.

<sup>8</sup> (Pjesa IV: Nenet 63-73 të Kodit Zgjedhor)





60 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Një kandidat/e mund të shfaqet vetëm në një listë, me përjashtim të kryetareve/ëve të partive që mund të kandidojnë në katër zona zgjedhore, por mund të mbajnë vetëm një mandat sipas zgjedhjes së tyre, nëse zgjidhen. Listat e kandidateve/ëve për Kuvendin, të paraqitura nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend, duhet të mbështeten nga jo më pak se 5 000 zgjedhës/e në shkallë kombëtare dhe për një koalicion jo më pak se 7 000 zgjedhës/e.

Për zgjedhjet vendore, partitë politike ose koalicionet zgjedhore të regjistruara duhet të depozitojnë në KQZ ose Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-të) jo më vonë se 50 ditë përpara ditës së zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës (shih më poshtë) për regjistrimin e kandidateve/ëve për kryetar/e bashkie dhe listën shumëemërore të kandidateve/ëve për anëtar/e të këshillave vendorë. Partitë politike që nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore për një periudhë të paktën prej gjashtë muajsh, duhet të depozitojnë nënshkrimet e jo më pak se 1 për qind e zgjedhësëve/sve të asaj njësie përkatëse.

## **Kandidatet/ët e pavarur**

Për *zgjedhjet e përgjithshme*, kandidatet/ët e pavarur mund të kandidojnë për t'u zgjedhur, por ata duhet të caktohen nga një grup me jo më pak se 9 zgjedhës/e (Komiteti Nismëtar) që banojnë në atë zonë zgjedhore përkatëse. Komiteti është përgjegjës për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidaten/in. Jo më vonë se 75 ditë para datës së zgjedhjeve, Komiteti Nismëtar regjistrohet në KQZ, duke paraqitur emrat e anëtareve/ëve të komitetit. Komiteti mund të regjistrojë një kandidat/e për deputet vetëm në rast se ka marrë mbështetje për kandidaten/in nga një numër zgjedhësësh/ish që i korrespondojnë jo më pak se 1 për qind të listës së zgjedhësëve/sve të zonës zgjedhore, por në çdo rast jo më shumë se 3 000 zgjedhës/e. Kandidatet/ët e pavarur përjashtohen nga ky detyrim nëse janë deputete/ë.

Për *zgjedhjet vendore*, krijohet një Komitet Nismëtar i përbërë nga jo më pak se 9 zgjedhës/e nga zona zgjedhore përkatëse, të cilët janë të ngarkuar për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidaten/in e pavarur për kryetar/e bashkie ose anëtar/e të këshillit vendor. Jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve, Komiteti Nismëtar regjistrohet në KZAZ, dhe depoziton emrat e anëtareve/ëve të komitetit. Komiteti mund të regjistrojë një kandidat/e për kryetar/e bashkie vetëm nëse ka marrë mbështetje për kandidaten/in nga një numër zgjedhësish që i korrespondojnë 1 për qind të listës së zgjedhësëve/sve të zonës zgjedhore, por, në çdo rast, jo më pak se 50



zgjedhës/e. Ligji kufizon numrin maksimal të firmave mbështetëse të kërkuara në 3 000 për partitë politike, por jo për kandidatet/ët e pavarur.<sup>9</sup> Në këto raste, kandidatet/ët duhet të depozitojnë nënshkrimin dhe fotokopje të letërnjoftimit të vlefshëm të zgjedhëseve/sve që firmosin në mbështetje të tyre. Kandidatet/ët e pavarur përjashtohen nga ky detyrim nëse janë kryetare/ë bashkie, anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse ose deputete/ë.

## E drejta për kandidim

Sipas Kushtetutës dhe Kodit Zgjedhor, kandidatet/ët që kanë të drejtë të kandidojnë për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore janë të gjithë shtetasit/it shqiptarë mbi 18 vjeç. Nuk ka kërkesa për arsimimin e kandidateve/ëve si për zgjedhjet e përgjithshme ashtu edhe për ato vendore. Për sa i përket vendbanimit, të drejtën për t'u zgjedhur kryetare/ë bashkie ose anëtarë/ë të këshillave vendore kanë vetëm shtetasit/it shqiptarë që kanë vendbanim të përhershëm në territorin e njësisë vendore përkatëse.

Shtetasit që kanë funksione specifike publike nuk mund të kandidojnë në zgjedhjet e përgjithshme pa hequr dorë më parë nga detyra. Këtu përfshihen gjyqtaret/ët, prokuroret/ët, ushtaraket/ët në shërbimin aktiv, punonjëset/it e policisë dhe të sigurimit kombëtar; përfaqësueset/it diplomatikë; kryetaret/ët e bashkive për zgjedhjet në Kuvend; anëtarë/ë të parlamentit, deputetet/ët, kur konkurrojnë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore; prefektet/ët në vendet ku kryejnë detyrat e tyre për zgjedhjet në Kuvend dhe për organet e qeverisjes vendore; kryetaret/ët dhe anëtarët/ët e komisioneve të zgjedhjeve; Presidenti i Republikës; dhe zyrtaret/ët e lartë të administratës shtetërore të përcaktuar me ligj. Në rast të zhvillimit të zgjedhjeve për Kuvendin dhe për organet e qeverisjes vendore në mënyrë të njëkohshme, kandidatet/ët regjistrohen vetëm në një lloj zgjedhjeje.

Gjithashtu, bazuar në Ligjin për Dekriminalizimin, individët që nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen përfshijnë ata që janë dënuar me burgim ose me dënim të mëparshëm për krime specifike,<sup>10</sup> si dhe ata të dëbuar nga territori i një numri vendesh ose për të cilët është lëshuar një urdhër kërkimi ndërkombëtar në disa shtete.<sup>11</sup>

<sup>9</sup> Po aty

<sup>10</sup> Neni 2 i ligjit nr. 138/2015 rendit një kategori të gjerë të veprave penale parashikuar në Kodin Penal të Shqipërisë

<sup>11</sup> Vendet e BE-së, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada dhe Australi



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është autoriteti që kryen verifikimin e kandidaturave për zgjedhje të përgjithshme për përshtatshmërinë, bazuar në informacionin e dhënë në formularët specifikë më poshtë. Në zgjedhjet vendore, procesi i verifikimit kryhet nga KQZ-ja dhe KZAZ-të. Për sa i përket verifikimit të kërkesave të Ligjit për Dekriminalizimin, KQZ-ja bashkëpunon me autoritetet e tjera përkatëse ligjzbatuese. Përpara regjistrimit të listave, KQZ-ja heq kandidatet/ët e papërshtatshëm dhe partive u jepet mundësia për t'i zëvendësuar ata. Pasi të regjistrohet, lista e kandidateve/ëve nuk mund të ndryshohet. Nëse informacioni i ri që rezulton në skualifikimin e një kandidateje/i vjen pas regjistrimit të listës, kandidatja/i mbetet në listë, por nuk mund të mbajë mandatin nëse zgjidhet. Prosesi i skualifikimit dhe heqjes së mandateve është i vazhdueshëm gjatë gjithë ciklit zgjedhor, duke respektuar kërkesën e balancës gjinore.<sup>12</sup> Subjektet zgjedhore nuk janë të detyruara të paguajnë asnjë tarifë për regjistrimin.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me [Udhëzimin nr. 1, 20 dhjetor 2020](#), jep udhëzime të hollësishme për subjektet zgjedhore (partitë politike, koalicionet dhe kandidatet/ët e pavarur) për procesin e regjistrimit të kandidateve/ëve, përfshirë dokumentet për verifikimin e kandidateve/ëve në zgjedhje, afatin kohor për publikimin e listave të kandidateve/ëve. Për më tepër, KQZ-ja ka miratuar një sërë formatesh specifike që duhet të plotësohen nga subjektet zgjedhore dhe kandidatet/ët për zgjedhjet qendrore dhe vendore.

Formularët që duhet të plotësohen nga partitë dhe kandidatet/ët, përfshirë kandidatet/ët e pavarur, i gjeni [këtu](#).

## Financimi i zgjedhjeve

Aspektet financiare të fushatës zgjedhore rregullohen me Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Partitë Politike. Ky i fundit rregullon edhe aspekte të përgjithshme të financimit të partive politike. Burimet kryesore të financimit të fushatës për subjektet zgjedhore janë:

- **fondet e dhëna paradhënie nga Buxheti i Shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore:** ka tre lloje të fondeve publike për partitë politike në bazë të rezultateve në zgjedhje:

<sup>12</sup> OSBE (2021), Zgjedhjet Parlamentare, 25 prill 2021, Raporti Perfundimtar i Misionit të Kufizuar të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i ODIHR-it



- *për veprimtaritë vjetore*: çdo vit në Buxhetin e Shtetit përcaktohet një fond i posaçëm që shërben si ndihmë financiare publike për partitë politike, që shpërndahet në përputhje me dispozitat e nenit 19 të Ligjit për Partitë Politike.
- *për veprimtaritë e lidhura me zgjedhjet*: partitë politike që kanë marrë jo më pak se 1 për qind të votave në shkallë vendi në zgjedhjet më të afërta pararendëse të të njëjtit lloj, përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit, në bazë të numrit të votave që secila parti ka marrë në ato zgjedhje.
- *Kompensimi financiar pas zgjedhjeve*: një rilogaritje e fondeve bëhet pas zgjedhjeve nga KQZ-ja sipas një formule të bazuar në mandatet e fituara nga partitë politike. Gjithashtu, subjektet zgjedhore që nuk kualifikohen për fonde publike përpara zgjedhjeve (kanë marrë më pak se 1 për qind të votave në zgjedhjet e fundit të të njëjtit lloj) mund të marrin kompensim pas zgjedhjeve, nëse marrin jo më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi. Kandidatet/ët e pavarur nuk kanë të drejtë për fonde publike, në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.<sup>13</sup>
- **të ardhurat e vetë subjektit zgjedhor të krijuara sipas ligjit**; (të tilla si kuotat financiare të anëtarësisë)
- **dhurimet jopublike për subjektin zgjedhor dhe kandidatet/ët e tij, në vlerë monetare, në natyrë ose shërbime të dhëna.**<sup>14</sup> Dhurimet mund të bëhen për: a) subjektin zgjedhor; dhe b) kandidatet/ët e tij (përfshirë kandidatet/ët e pavarur) vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas, ku përfshihen edhe shtetas/e shqiptarë/e që banojnë jashtë territorit të vendit. Dhurimet që u jepen kandidateve/ëve konsiderohen si kontribute për partinë politike për të cilën ata kandidojnë, nëse nuk janë kandidatë të pavarur. Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t'i japë një subjekti zgjedhor, përfshirë kandidatet/ët e tij, nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose vlera ekuivalente në natyrë ose shërbime.
  - Dhurimi i fondeve jopublike mbi 50 mijë lekë duhet bërë vetëm në një llogari bankare të posaçme të hapur nga subjekti zgjedhor. Subjektet zgjedhore deklarojnë llogaritë bankare të përdorura për donacione kur regjistrohen në KQZ (sipas kërkesave të regjistrimit si subjekte zgjedhore në përputhje me nenin 67 të Kodit) dhe nuk mund të përdorin asnjë llogari tjetër bankare, përveç atyre të deklaruara, për pranimin e dhurimeve për fushatën zgjedhore, qoftë edhe për shumën më të vogël se 50 mijë lekë. Në formularin e deklarimit përfshihet edhe autorizimi për KQZ-në dhe të ngarkuarit e saj për të marrë drejtpërdrejt nga banka të dhëna për të gjitha transaksionet e

<sup>13</sup> OSBE (2021), Zgjedhjet Parlamentare, 25 prill 2021, Raporti Perfundimtar i Misionit të Kufizuar të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i ODIHR-it

<sup>14</sup> KQZ-ja përcakton me vendim rregullat dhe modalitetet e nevojshme për llogaritjen e vlerës monetare të donacioneve në natyrë ose shërbimeve të ofruara, sipas vlerës së tregut në momentin e dhënies së tyre.

- Ilogarisë. Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhurueses/it, huadhënëses/it ose kredidhënëses/it.
  - Donacionet nën 50 mijë lekë mund t'u bëhen edhe drejtpërdrejt kandidateve/ëve në llogarinë bankare që përdorin normalisht. Por, nëse planifikojnë të pranojnë dhurime për fushatën e tyre me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë, janë të detyruar të hapin llogari bankare të posaçme për të pranuar dhurimin e fondeve jopublike. Në këtë rast duhet të deklarohen edhe llogaritë e individit, kur subjekti zgjedhor i kandidatit regjistrohet si i tillë 70 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, sipas nenit 67 të këtij ligji. (shih Kutinë 2 më poshtë)
  - Të njëjtat detyrime si më sipër vlejnë edhe për kandidatet/ët e pavarur të propozuar nga zgjedhëset/it.
- **huatë ose kreditë e marra nga partitë politike ose kandidatet/ët e tyre, përfshirë kandidatet/ët e pavarur:** Këto janë burime të tjera për financimin e fushatës elektorale dhe zbatohet legjislacioni përkatës për huamarrjen dhe kredidhënien. Në asnjë rast vlera e një huaje ose kredie nuk duhet të kalojë shumën 1 milion lekë ose vlerën ekuivalente në natyrë apo shërbime.<sup>15</sup>

## Ndalimet në lidhje me financimin e zgjedhjeve

Sipas Kodit Zgjedhor, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidateve/ëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. Neni 91 i Kodit Zgjedhor jep parashikime të hollësishme për kufizimet në lidhje me ndalimin e përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore.

Po ashtu, ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik (apo çdo aksionar i tij) që:

<sup>15</sup> Kjo shumë indeksitet nga KQZ-ja çdo pesë vjet përkundrejt shkallës së inflacionit

- ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 3 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë. Ky ndalim zbatohet edhe në rastin e nënkontraktimeve apo të kontratave të partneritetit publik privat;
- ushtron veprimtari në fushën e medias;
- ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme;
- ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik. Ky detyrim nuk zbatohet nëse aksionari i zotëron këto aksione si rezultat i ofertës publike.

Personat fizikë ose personat juridikë, që i kanë bërë dhurime një subjekti zgjedhor apo kandidateve/ëve të tij në zgjedhje, nuk mund të përfitojnë për periudhën deri 3 vjet pas datës së zgjedhjeve kontrata publike, kontrata të partneritetit publik privat ose në çdo mënyrë tjetër fonde me vlerën totale që tejkalon shumën prej 10 milionë lekësh, përfshirë edhe si nënkontraktues të një kontrate/koncesioni publik. Donatorëve u kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë ku thuhet se nuk janë në asnjë nga rrethanat e parashikuara më sipër dhe se mbajnë përgjegjësi personale për deklaram të rremë.<sup>16</sup>

## Shpenzimet, raportimi dhe monitorimi i veprimtarive financiare të subjekteve zgjedhore dhe kandidateve/ëve

Pavarësisht shumës së dhurimeve të marra, shuma e shpenzimeve<sup>17</sup> të bëra nga një subjekt zgjedhor, përfshirë kandidatet/ët e tij, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të jetë më shumë se 3 herë më e madhe se shuma më e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore. Shpenzimi total që mund të kryejë kandidatja/i i propozuar nga zgjedhëset/it nuk duhet të kalojë 50 për qind të shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike.

Shpenzimet e fushatës zgjedhore duhet të dokumentohen në përputhje me legjislacionin fiskal. Partive politike u kërkohet të miratojnë rregullore të brendshme për menaxhimin e fondeve që marrin kandidatet/ët e tyre. Subjektet zgjedhore janë gjithashtu përgjegjës për të koordinuar informacionin financiar dhe aktivitetet e kandidateve/ëve gjatë fushatës, si dhe u kërkohet të miratojnë rregulla të brendshme dhe sanksione për raportimin e të ardhurave

<sup>16</sup> Forma dhe përmbajtja e deklaratës miratohet nga KQZ-ja dhe është e detyrueshme të nënshkruhet në çdo rast dhurimi.

<sup>17</sup> “Shpenzim fushate” është çdo shpenzim që bën një parti ose kandidatet/ët e saj për qëllime të fushatës zgjedhore, pavarësisht datës se kur është bërë.



dhe shpenzimeve nga kandidatja/i te subjekti zgjedhor, në mënyrë që të mos ketë donator/e, huadhënës/e apo kredidhënës/e që tejkalon kufirin prej 1 milion lekësh ose vlerën ekuivalente në natyrë ose shërbime.<sup>18</sup>

Subjektet zgjedhore, përfshirë kandidatet/ët e pavarur, janë të detyruara të paraqesin një raport financiar për fushatën zgjedhore në KQZ brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve, sipas modeleve të miratuara nga KQZ-ja. Raporti duhet të përfshijë informacion të hollësishëm për të gjitha burimet e marra dhe të përdorura për zgjedhje, duke përfshirë një regjistër të donatorëve, huadhënësve/eve dhe kredidhënësve/eve. Neni 92/3 i Kodit Zgjedhor parashikon udhëzime të hollësishme mbi informacionin në burimet financiare dhe arkivat e subjekteve zgjedhore. Pas zgjedhjeve vendore të vitit 2023, KQZ-ja krijoi një Sistem të Raportimit Financiar Online, duke lehtësuar raportimin, zbulimin, aksesin në informacionin financiar dhe duke përmirësuar transparencën e financimit të fushatës.<sup>19</sup>

KQZ-ja mbikëqyr respektimin e rregulloreve të financimit të fushatës, përmes monitorimit të fushatës për të mbledhur informacion (119 monitorues/e u angazhuan në zgjedhjet e fundit vendore të vitit 2023). Pas kësaj, KQZ-ja cakton auditues për të shqyrtuar këto raporte financiare dhe publikon raportet e auditimit për subjektet zgjedhore jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së raportit. Kodi Zgjedhor parashikon një gamë të gjerë sanksionesh për shkeljet e financimit të fushatës, duke përfshirë gjopa nga 50 000 deri në 5 000 000 lekë, konfiskim të fondeve publike dhe pezullim të financimit publik deri në pesë vjet.<sup>20</sup>

## Periudha zgjedhore dhe fushata

Data e zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore përcaktohet me dekret të Presidentit të Republikës, bazuar në rregulla të veçanta të Kodit Zgjedhor. Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve. Dita para datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve, deri në orën e mbylljes së qendrave të votimit, përbëjnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore nuk lejohet

<sup>18</sup> Subjektet zgjedhore mund të mbajnë përgjegjësi për shkeljen e kushteve dhe detyrimeve të financimit nga vetë kandidatet/ët e tyre, me përjashtim të rasteve kur nga hetimi administrativ konstatohet se ishte e pamundur për subjektin zgjedhor ose, me gjithë përpjekjet e bëra, nuk mundi të parandalonte ose korrigjonte shkeljen e bërë nga kandidati. Në këtë rast, përgjegjësia administrative dhe sanksionet për shkeljen i takojnë kandidati.

<sup>19</sup> OSBE (2023), Zgjedhjet vendore, 24 maj 2023, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i ODIHR-it, Raporti përfundimtar

<sup>20</sup> Po aty





asnjë fushatë zgjedhore përmes organeve mediatike, si dhe tubime apo aktivitete të tjera zgjedhore të subjekteve zgjedhore.

## Barazia gjinore dhe zgjedhjet në Shqipëri

### Zgjedhjet e përgjithshme

Që nga viti 2008, legjislacioni shqiptar garanton të paktën 30 për qind përfaqësim të gjinisë më pak të përfaqësuar në pozicione vendimmarrëse politike dhe publike (Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri). Kjo u pasqyrua edhe në Kodin Zgjedhor, të miratuar po atë vit. Megjithatë, ndryshimi i Kodit Zgjedhor në vitin 2012 bëri përmirësime të mëtejshme për të përforcuar zbatimin e kuotës minimale për gratë kandidatë në zgjedhjet e përgjithshme në 30 për qind. Të paktën një e treta e kandidatëve/ëve të gjinisë më pak të përfaqësuar duhet të nominohet në secilën listë. Duke marrë parasysh paqartësinë e Kodit për renditjen e grave në listat e kandidatëve/ëve, KQZ-ja interpretoi se në çdo tre emra të kandidatëve/ëve (duke filluar nga numri një i listës) të paktën një duhet të jetë grua.<sup>21</sup> Neni 163, i cili ka të bëjë me përlllogaritjen dhe shpërndarjen e votave në bazë të një formule, garanton edhe kuotën gjinore prej 30 për qind në listën e kandidatëve/ëve të zgjedhur. Sanksionet për mosrespektimin e kuotave gjinore deri në vitin 2020 përbëheshin nga gjoba, të cilat u konsideruan joefektive, pasi disa parti politike preferonin të paguanin gjobat në vend që të respektonin kuotat.<sup>22</sup>

Në vitin 2020, Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor u ndryshuan sërish duke çuar në përmirësime shtesë.<sup>23</sup> Kodi Zgjedhor futi një dispozitë të posaçme duke vendosur një kuotë gjinore prej 30 për qind për të gjitha nivelet e administratës zgjedhore (neni 4). KQZ ka autoritetin të monitorojë dhe mbështesë zbatimin e parimeve të barazisë gjinore nga të gjithë aktorët e përfshirë. Një zhvillim tejet pozitiv në vitin 2020 ishte një sanksion i ri, i cili i jep KQZ-së autoritetin të refuzojë listat e kandidatëve/ëve të partive politike që nuk respektojnë kuotën gjinore, duke zëvendësuar sistemin e mëparshëm të sanksionimit me anë të gjobave. Një zhvillim shumë pozitiv në vitin 2020 ishte një sanksion i ri, i cili i jep KQZ-së autoritetin për të refuzuar listat e kandidatëve të partive politike që nuk respektojnë kuotën gjinore. Deri atëherë, sistemi i gjobave ishte i vetmi sanksion që mund të zbatohet për partitë

<sup>21</sup> OSBE (2021), Zgjedhjet Parlamentare, 25 prill 2021, Raporti Perfundimtar i Misionit të Kufizuar të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i ODIHR-it

<sup>22</sup> Un Women, Albania (2020), Profili i Barazisë Gjinore, Shqipëri

<sup>23</sup> Në vitin 2020, Grupi i Punës për Gjininë dhe Barazinë në Vendimmarrje (një grup me organizata ndërkombëtare dhe vendase përfshirë UN Women dhe OSBE)



politike që nuk respektonin kuotat gjinore. Dhe në fakt, në disa raste, disa parti politike preferuan të paguanin gjobën në vend që të respektonin kuotat, siç ndodhi gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017, ku KQZ gjobiti dy parti politike për mosrespektimin e kërkesave për kuotat gjinore në listat e tyre të kandidatëve. Kodi Zgjedhor synon gjithashtu të trajtojë pabarazinë gjinore në zgjedhje përmes marrjes së masave për reduktimin dhe eliminimin e votimit për të tretët dhe votimit familjar. Për më tepër, ligji kërkon që autoritetet të mbledhin dhe publikojnë statistika për zgjedhëset/it të ndara sipas gjinisë, gjë që mundëson analizën gjinore të pjesëmarrjes në zgjedhje dhe marrjen e masave për të nxitur pjesëmarrjen në të ardhmen.

Këto zhvillime në legjislacion kontribuan në rezultate pozitive gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të fundit të prillit 2021. Partitë kryesore politike u përpoqën të rrisin dukshëm numrin e grave si kandidatë në fushatë dhe kuota e detyrueshme për gratë u tejkalua në shumicën e listave të kandidatëve/ëve.<sup>24</sup> Në mesin e deputetëve të zgjedhur në Kuvend, 90 janë burra (64.3%) dhe 50 gra (35.7%), numri më i madh i grave në historinë e tij.<sup>25</sup> Kryetarja e Kuvendit është grua dhe që nga gushti 2024, 9 nga 17 ministra janë gra (53%).<sup>26</sup>

Me ndryshimet e fundit të vitit 2024 në Kodin Zgjedhor, janë futur parashikime për të garantuar kuotën gjinore prej 30 për qind. Në mënyrë më specifike, sipas nenit 67/6, për çdo zonë zgjedhore në zgjedhjet për Kuvendin një në çdo tre emra të kandidatëve/ëve të dyja listave (listës shumëemërore me renditje të fiksuara dhe shumëemërore që i nënshtrohet votimit parapëlqyes) i përket gjinisë më pak të përfaqësuar dhe një në çdo tre emra të listës duhet t'i përkasë gjinisë më pak të përfaqësuar. Po ashtu, sipas nenit 163/2, kandidatet/ët e listës shumëemërore që i nënshtrohen votimit parapëlqyes rirenditen në bazë të numrit më të lartë të votave parapëlqyese për secilin kandidat. Në rastet kur nga rirenditja nuk rezulton që duke filluar nga kreu i kësaj liste, një në çdo tre emra i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, atëherë kandidatja/i e/i tretë në këtë listë dhe në vijim një në çdo tre emra të saj i përket gjinisë më pak të përfaqësuar sipas numrit të votave që këto të fundit kanë marrë. Qëllimi i kësaj dispozite është të sigurojë zbatimin e kuotës gjinore në nivelin e rezultatit zgjedhor në listat preferenciale dhe jo vetëm në nivelin e përbërjes së listave.

Ndryshimet e Kodit Zgjedhor në Shkurt 2025, nuk kishin të bënin me dispozitat mbi përfaqësimin gjinor.

<sup>24</sup> OSBE/Raporti i ODHIR-it për Zgjedhjet Parlamentare në Shqipëri, prill 2021, <https://www.osce.org/files/f/documents/5/1/493687.pdf>

<sup>25</sup> <https://data.ipu.org/parliament/AL/AL-LC01/>

<sup>26</sup> <https://www.kryeministria.al/qeveria/>



## Zgjedhjet vendore

Dispozitat e paraqitura me ndryshimet ligjore të vitit 2020 garantojnë një kuotë gjinore prej 50 për qind për këshillat vendorë në listat e kandidatëve/ëve që kërkohen për të përfaqësuar në mënyrë të barabartë gratë dhe burrat dhe kandidatët/ët e gjinive të ndryshme të alternuara në listë. Sanksioni i Kodit Zgjedhor për refuzimin e listës së kandidatëve/ëve për mosrespektim të kuotës gjinore zbaton parimin e barazisë në zgjedhjet për këshillat vendorë (nenet 67/6, 67/7 dhe 175). Nga ana tjetër, për kandidatët/ët për kryetar/e bashkie, nuk ka kërkesë për kuotë gjinore.

Këto përmirësime u reflektuan edhe në zgjedhjet e fundit vendore të majit 2023, kur nga 23 763 kandidatë/ë për këshilla vendorë, 11 828 ishin gra (49.8 për qind). Megjithatë, misioni i monitorimit të zgjedhjeve ka vënë në dukje se në disa bashki kuota nuk është respektuar dhe zbatuar gjithmonë (duke rezultuar në gjithsej 37 kandidatë gra më pak. Gjithsesi, në përgjithësi, gratë ishin të përfaqësuara mirë në listat e kandidatëve/ëve.<sup>27</sup> Përkundrazi, mungesa e detyrimit për të respektuar çdo kuotë gjinore për kandidatët/ët për kryetar/e bashkie çoi në vetëm 15 gra kandidatë mes 144 kandidatëve/ëve në total (10 për qind), nga të cilat u zgjodhën 8. Ato përfaqësojnë 13% të numrit të përgjithshëm të kryetareve/ëve të bashkive, duke mos shënuar asnjë progres në krahasim me zgjedhjet e mëparshme vendore.

## Sfidat në lidhje me barazinë gjinore

Përveç mungesës së kuotave gjinore për kandidatët/ët për kryetar/e bashkie, legjislacioni shqiptar nuk rregullon shpërndarjen e fondeve të fushatës nga subjektet zgjedhore për kandidatët/ët e tyre, gjë që mund të sjellë që gratë kandidatë të marrin më pak fonde për fushatë.

Për më tepër, grupet e pafavorizuara dhe veçanërisht gratë nga këto grupe mbeten kryesisht shumë pak të përfaqësuara në jetën politike dhe publike, përfshirë organet e zgjedhura, qeverinë dhe administratën publike në të dy nivelet, qendrore dhe vendore, policinë e shtetit ose forcat e armatosura. Për shembull, gjatë zgjedhjeve të fundit vendore të majit 2023, nga 23 763 kandidatë për 1 603 poste të këshilltarëve vendorë, vetëm nëntë ishin anëtarë të komunitetit rom. Nuk ka asnjë informacion për gjininë e këtyre kandidatëve/ëve dhe pjesëmarrjen e

<sup>27</sup> OSBE (2023), Zgjedhjet vendore, 24 maj 2023, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i ODIHR-it, Raporti Përfundimtar

personave me aftësi të kufizuara, përfshirë gratë me aftësi të kufizuara si votuese dhe kandidatë.<sup>28</sup> Në mënyrë të ngjashme, asnjë grua nga komunitetet e pafavorizuara nuk është aktualisht në Kuvend ose në Këshillin e Ministrave. E vetmja grua me aftësi të kufizuara që ka qenë në postin e zëvendësministres në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale disa vite më parë e ka lënë atë detyrë.

Boshllëqe të tjera në legjislacion, lidhen me mungesën e mbrojtjes specifike për dhunën ndaj grave në politikë dhe zgjedhje.<sup>29</sup> Dhuna ndaj grave në zgjedhje përfshin forma të ndryshme të sulmit, shtrëngimit dhe frikësimit në internet që kërkojnë të përjashtojë gratë nga politika thjesht sepse ato janë gra. Në Shqipëri, stereotipet gjinore, rritja e shqyrtimit mbi jetën private dhe pamjen e grave kandidatë dhe jo për arritjet profesionale, sulmet joetike si nga kundërshtarët/ët politikë ashtu edhe nga anëtarët/ët e të njëjtave përkatësi politike ishin të pranishme gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2021 dhe u pasqyruan dhe/ose u përforcuan gjerësisht në media.<sup>30</sup> Një analizë e legjislacionit<sup>31</sup> zbuloi disa boshllëqe në lidhje me dispozitat që duhet të trajtojnë format e ndryshme të dhunës ndaj grave në politikë.<sup>32</sup>

Këto ishin shqetësimet e ngritura edhe nga Komiteti CEDAW në Vëzhgimet e tij të fundit Përmbyllëse drejtuar Shqipërisë në tetor 2023.<sup>33</sup> Komiteti shprehu shqetësime në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- Fakti që vetëm 13 për qind e bashkive drejtohen nga gra;
- Vazhdimi i barrierave strukturore për pjesëmarrjen e grave në jetën politike dhe publike, veçanërisht për gratë në zonat rurale, gratë me aftësi të kufizuara, gratë që u përkasin pakicave etnike dhe gratë lezbike, biseksuale, transgjinore dhe interseksuale;

<sup>28</sup> Po aty. Nuk ka ende informacion mbi numrin e anëtarëve të komunitetit rom që janë zgjedhur aktualisht. Ndoshta ky informacion dhe informacioni mbi pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara do të jetë i disponueshëm në raportin përfundimtar të Misionit Ndërkombëtar të Monitorimit të Zgjedhjeve.

<sup>29</sup> Sipas UN Women dhe UNDP, dhuna ndaj grave në zgjedhje është një formë e dhunës ndaj grave që synon të ndikojë te realizimi i të drejtave politike të grave në kontekstin zgjedhor. Ajo manifestohet në forma të ndryshme, përfshirë dhuna fizike dhe psikologjike, dhuna përmes gjuhës së urrejtjes për shkak të gjinisë, kanosja, frikësimi, ngacmimi dhe edhe dhuna seksuale, dhuna ndaj pjesëmarrjes së grave si kandidatë, zgjedhëse, aktiviste, përkrahëse të partive, vëzhguese, punonjëse në zgjedhje, ose zyrtare publike. Informacion shtesë mund të gjendet tek Udhëzues programimi “Parandalimi i dhunës ndaj grave në zgjedhje”, UN Women and UNDP, 2017, gjendet tek: <https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2017/preventing-vaw-in-elections-en.pdf?la=en&vs=3742>

<sup>30</sup> Raport monitorimi: Dhuna ndaj grave në zgjedhjet (VAWE) dhe paragjykimet gjinore në mbulimin mediatik gjatë zgjedhjeve të vitit 2021 në Shqipëri, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve me mbështetjen e UN Women, Shqipëri, Nëntor 2021.

<sup>31</sup> Analiza përfshin Kushtetutën, Kodin Zgjedhor, Kodin Penal dhe legjislacionin që lidhet me partitë politike.

<sup>32</sup> Analizë e legjislacionit shqiptar për mbrojtjen nga dhuna ndaj grave në zgjedhje, UN Women, Albania, 2020 <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2021/05/analysis-of-the-albanian-legislation-on-protection-from-violence-against-women-in-elections>;

<sup>33</sup> Komiteti i Ekspertëve të Pavarur i ngarkuar me monitorimin e zbatimit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).

- Gjuha e urrejtjes dhe ngacmimi në diskursin politik ndaj grave politikane dhe kandidate, që pengojnë pjesëmarrjen e grave në jetën politike dhe publike.

Mbi bazën e këtyre gjetjeve, Komiteti rekomandoi:

- Sigurimi i ngritjes së kapaciteteve në leadershipin politik dhe aftësitë për fushatë, si dhe aksesin në fondet e fushatës për gratë kandidate;
- Miratimi i masave të përkohshme të veçanta, si kuotat staturore dhe një sistem i barazisë gjinore, në përputhje me nenin 4 (1) të Konventës dhe Rekomandimin e përgjithshëm 25 (2004) të Komitetit për masa të përkohshme të veçanta për të garantuar përfaqësimin e barabartë të grave, përfshirë gratë në zonat rurale, gratë me aftësi të kufizuara, gratë që u përkasin pakicave etnike dhe gratë lezbike, biseksuale, transgjimore dhe interseksuale, në Kuvend dhe organet e kegjislative të bashkive, qeveri, shërbimin civil dhe shërbimin e huaj, në veçanti në nivelet vendimmarrëse;
- Forcimi i mekanizmave për parandalimin e gjuhës së urrejtjes kundër grave politikane dhe grave kandidate në diskursin politik dhe publik, përfshirë në internet, dhe parandalimi i ngacmimeve dhe kërcënimeve ndaj tyre, duke përfshirë forcimin e mekanizmave të raportimit dhe monitorimit, duke u kërkuar të gjitha partitë politike të miratojnë kode sjelljeje për të promovuar barazinë gjinore dhe luftuar ngacmimet kundër kandidateve dhe aktivisteve gra, si dhe kompanitë e mediave sociale të mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen diskriminuese të krijuar nga përdorueset/it.<sup>34</sup>

## Zhvillimet e fundit ndërkombëtare për barazinë gjinore në zgjedhje

Detyrimet e Shqipërisë për pjesëmarrjen politike të grave rrjedhin nga një sërë standardesh ndërkombëtare, përfshirë [Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave](#) (CEDAW) që mbështet të drejtën e grave për të marrë pjesë në jetën publike, dhe [Platformën për Veprim të Pekinit](#), e cila bën thirrje për eliminimin e të gjitha barrierave për pjesëmarrje të barabartë. Gjithashtu, nëpërmjet [Objektivit 5 të Zhvillimit të Qëndrueshëm](#), Shtetet kanë marrë përsipër “arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave”, ç’ka kërkon të “sigurohet pjesëmarrja e plotë dhe efektive e grave dhe mundësi të barabarta për udhëheqje në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në politikë, ekonomike dhe jeta publike” (objektivi 5.5.). Treguesit

<sup>34</sup> Komiteti CEDAW (2023), Vëzhgimet përmbyllëse për raportin e pestë periodik të Shqipërisë





përfshijnë "proporcionin e vendeve të mbajtura nga gratë në parlamentet kombëtare dhe qeveritë vendore" (5.5.1.) dhe "proporcionin e grave në pozicione drejtuese".

Komiteti CEDAW, organi i ngarkuar ndër të tjera, për interpretimin e dispozitave të Konventës CEDAW nxjerr Rekomandime të Përgjithshme. Komiteti nxori [Rekomandimin e tij të parë të Përgjithshëm mbi Pjesëmarrjen e Grave në Politikë](#), Nr.23 (1997), i cili është përditësuar së fundmi nëpërmjet [Rekomandimit të Përgjithshme Nr.40](#) (2024) mbi përfaqësimin e barabartë dhe gjithëpërfshirës të grave në sistemet vendimmarrëse. Komiteti ofron udhëzime gjithëpërfshirëse për shtetet për arritjen e përfaqësimit të barabartë dhe gjithëpërfshirës të grave në të gjitha sistemet vendimmarrëse në të gjithë sektorët, duke synuar një ndryshim sistemik. Ai përshkruan masat legislative, politike dhe programore për të siguruar zbatimin e këtij detyrimi dhe për të kapërcyer sfidat globale. Ky dokument përkufizon "përfaqësimin e barabartë dhe gjithëpërfshirës" si barazi pesëdhjetë e pesëdhjetë midis grave dhe burrave në të gjithë diversitetin e tyre për sa i përket aksesit të barabartë dhe fuqisë së barabartë brenda sistemeve vendimmarrëse.

Për këtë qëllim, Komiteti identifikon shtatë shtylla të përfaqësimit të barabartë dhe gjithëpërfshirës në sistemet vendimmarrëse: (a) barazi pesëdhjetë e pesëdhjetë midis grave dhe burrave në sistemet vendimmarrëse si pikënisje dhe normë universale; (b) përfshirjen e rinisë në udhëheqje e kushtëzuar nga barazia gjinore; (c) ndërsektorialiteti (ndërlidhja e gjinisë me faktorë të tjerë si etnia, aftësia e kufizuar) dhe përfshirja e grave në të gjithë diversitetin e tyre në sistemet vendimmarrëse; (d) një qasje gjithëpërfshirëse ndaj sistemeve vendimmarrëse në të gjithë sferat; (e) pushtet dhe ndikim të barabartë të ushtruar nga gratë në sistemet vendimmarrëse; (f) transformimi strukturor për përfaqësimin e barabartë dhe gjithëpërfshirës të grave në sistemet vendimmarrëse; dhe (g) përfaqësimi i shoqërisë civile në sistemet vendimmarrëse.